



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE**

Nr. 05/24 Prot.

Tiranë, më 29.01.2021

V E N D I M

Nr. 11, datë 29.01.2021

**Për emërimin e z. Gerald Blaceri oficer i policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë
Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.**

Komisioni i Policisë Gjyqësore, i mbledhur në datën 29.01.2021, pasi mori në shqyrtim Propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.1506/138 ex-20 prot, datë 25.01.2021 “Propozim për emërim të oficerëve të policisë gjyqësore”, administroi gjithë praktikën e ndjekur nga Prokuroria e Përgjithshme për organizimin dhe kryerjen e fazës së konkurimit të zhvilluar për përzgjedhjen e kandidatëve për oficerë të policisë gjyqësore dhe diskutoi çështjen në tërësi

KONSTATOI :

Prokurori i Përgjithshëm, ka përcjellë në Komisionin e Policisë Gjyqësore kërkesën nr. 1506/138 ex 20 prot., datë 25.01.2021, nëpërmjet së cilës propozon emërimin e 13 oficerëve të policisë gjyqësore, në seksionet e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, mbështetur në nenin 18, pika 2 e ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Në propozimin e Prokurorisë së Përgjithshme, parashtrohet procedura e ndjekur nga Prokurori i Përgjithshëm për përzgjedhjen e emrave që propozohen për tu emëruar si oficer të Policisë Gjyqësore, për të plotësuar vendet vakant për oficerë të policisë gjyqësore, të shpallura nga ky institucion me njoftimin e datës 12.10.2020. Propozimi përmban emrat e kandidatëve të cilët kanë rezultuar fitues në konkurimin e organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe propozohen për tu emëruar Oficerë të Policisë Gjyqësore.

Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm shoqërohet me dokumentacionin e mbajtur për gjithë fazat e procesit administrativ që ky institucion ka zhvilluar për zhvillimin e konkurimit dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues.

Në listën e të propozuarve, Prokurori i Përgjithshëm ka përfshirë kandidatin fitues, Gerald Blaceri, duke propozuar emërimin e tij oficer i Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Nga përmbajtja e propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe akteve që e shoqërojnë, rezulton se:

Prokurori i Përgjithshëm, në ushtrim të kompetencave që i jep ligji 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 2, gërmat “dh” dhe “e” dhe ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, nenet 17 dhe 18, me njoftimin nr.1506 prot., datë 12.10. 2020 ka bërë shpalljen e vendeve të lira për 13 oficerë të policisë gjyqësore në seksionet e policisë gjyqësore të disa prokurorive të shkallës së parë, të juridiksionit të përgjithshëm. Në njoftim specifikohen prokuroritë ku ekzistojnë vendet e lira dhe numri i tyre për çdo prokurori. Njoftimi është shpallur në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme dhe është afishuar në ambientet e dukshme të godinës së këtij institucioni, duke ftuar të interesuarit të aplikojnë për këto vende.

Me urdhërin nr.131, datë 12.10.2020, “Për caktimin e Komisionit të Vlerësimit të Aftësive” Prokurori i Përgjithshëm ka ngarkuar Komisionin e Vlerësimit të përbërë nga tre prokurorë, për kryerjen e procedurës së konkurimit të kandidatëve, sipas fazave dhe rregullave të parashikuara në Rregulloren nr.21/6, datë 10.06.2020 “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të Prokurorisë”.

Sikurse rezulton nga aktet, bashkëlidhur propozimit, konkurimi është zhvilluar sipas procedurës së parashikuar në rregulloren e sipërcituar.

Rezulton se pas skualifikimit të kandidatëve nga verifikimi paraprak, për mosplotësim kriteresh, janë kualifikuar dhe kanë marrë pjesë në konkurim 94 kandidatë. Konkurimi është zhvilluar në tre faza, faza e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve, faza e vlerësimit profesional me shkrim dhe faza e intervistës së strukturuar me gojë.

Në përfundim të konkurimit të kandidatëve për vendet vakant të shpallura sipas njoftimit nr.1506 prot., datë 12.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, Komisioni pasi ka bërë vlerësimin me pikë për secilin kandidat, ka hartuar Listën Përfundimtare të kandidatëve, të renditur nga kandidati që ka marrë më shumë pikë te ata që kanë marrë më pak.

Bazuar në renditjen përfundimtare dhe verifikimeve përkatëse të 13 kandidatëve të renditur të parët, rezulton se kandidati Gerald Blaceri është shpallur fitues për një nga vendet e shpallura vakant dhe plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ligji. Për këto arsye, Prokurori i Përgjithshëm e ka propozuar z. Gerald Blaceri për ta emëruar si oficer të policisë gjyqësore në seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, vend për të cilin ai ka kandiduar.

Duke patur parasysh sa më sipër, referuar propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm, akteve që u administruan nga Komisioni dhe akteve ligjore që rregullojnë organizimin dhe veprimtarinë Policisë Gjyqësore, Komisioni i Policisë Gjyqësore e gjen të bazuar në ligj dhe prova kërkesën

e Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin e z. Gerald Blaceri si oficer të policisë gjyqësore në seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Rezulton se kandidati Gerald Blaceri plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 17 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë gjyqësore” për tu përzgjedhur si oficer i policisë gjyqësore të seksioneve të policisë gjyqësore të prokurorisë. Përzgjedhja e tij është bërë mbi bazën e zhvillimit të një konkurimi të drejtë dhe transparent, sipas kërkesave të ligjit dhe Rregullores nr.21/6 datë 10.06.2020 të Komisionit të Policisë Gjyqësore “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të Prokurorisë”.

Gjithashtu kandidati ka shfaqur pëlqimin për kryerjen e trajnimit fillestar për hetiminin, si një nga kushtet e kërkuara nga neni 17, pika “ç” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë gjyqësore”.

Referuar procesit të përzgjedhjes së kandidatëve fitues, që është zhvilluar nga Prokurori i Përgjithshëm, si një proces objektiv, i studjuar dhe në respektim të akteve ligjore dhe kompetencave që ligji i njeh Prokurorit të Përgjithshëm, Komisioni i Policisë Gjyqësore nuk konstaton pengesa ligjore për emërimin e oficerit të policisë gjyqësore Gerald Blaceri.

Për sa më sipër, Komisioni i Policisë Gjyqësore, bazuar në nenin 10, pika 1, gërma “b”, nenin 11, pika 4 të Ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

V E N D O S I :

1. Emërimin e zotit **Gerald Blaceri** oficer të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Korçë**.
2. Për këtë vendim njoftohet zoti **Gerald Blaceri**.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme.

K O M I S I O N I

KRYETARI
ALFRED PROÇONATI

ANËTAR
BLEDAR ÇELIKU

ANËTAR
ARTUR SEJATI

ANËTAR
HARI GOGO

ANËTAR
ALBERT MUÇO

